

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Seanca Plenare**

Seanca nr.2003/32

Prishtinë,më 13 nëntër 2003,në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Gojko Saviq,anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 105 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për shëndetësi-nr.2003/31;
3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;
4. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve dhe
5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të datës 20 nëntor 2003.

**Kryetari** kërkoi nga deputetët e Kuvendit të procedohej sipas rendit të ditës të miratuar në seancën e mëparshme.

### **1.Miratimi i procesverballi të seancës së mëparshme.**

Procesverballi i seancës të mëparshme u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për shëndetësi-nr.2003/31.**

**Kryetari** e ftoi ministren e Shëndetësisë ta arsyetonte P/ligjin para deputetëve të Kuvendit.

**Ministrja Resmije Mumxhiu** theksoi se objektivat kryesore të këtij P/ligji janë të sigurohet qëndrueshmëria, efikasiteti dhe ligjshmëria në sistemin shëndetësor të Kosovës,që përfshin këto fusha:

- Shtimi i racionalitetit efektiv përmes ndërtimit të konceptit të organizimit dhe të shfrytëzimit të resurseve njerëzore,të infrastrukturës dhe të produkteve farmaceutike;
- Përshtatja e politikave zhvillimore në pajtim me zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës dhe mundësitë e qytetarëve;
- Dizajnimi i decentralizimit mbi bazat e efikasitetit të shtuar ekonomik dhe shëndetësor;
- Barazimi i sektorit privat dhe publik, si dhe sigurimi i mundësisë për forma të përziera të punës në shëndetësi;
- Ndërtimi i konceptit të financimit publik të shëndetësisë.

Bazuar në këto objektiva, P/tligji përcakton parimet themelore të sistemit, të kujdesit dhe të financimit shëndetësor si dhe mbështetje institucionale dhe juridike me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së sistemit dhe sundimit të ligjit.

Me këtë P/ligj rregullohet në mënyrë institucionale kujdesi shëndetësor të zbatohet në nivel parësor, dytësor dhe tretësor. Kjo do të sigurohet me organizimin e veprimtarisë shëndetësore në kuadër të sektorit publik, sektorit privat dhe sektorit të përzier. Këtë sistem do ta mbështesë mjekësia familjare që duhet të mbulojë 90% të kujdesit shëndetësor të popullsisë, si dhe mjekësia dytësore dhe tretësore nëpërmjet sigurimit të vëllimit të hospitalizimit në mesataren e pritur prej 110 seancave të shërimit spitalor në 1000 banorë me një trajtim mesatar të hospitalizimit në kohëzgjatje prej 8 deri 12 ditë.

Me këtë Projektligj financimi i kujdesit shëndetësor të qytetarëve vazhdon të sigurohet prej buxhetit qendror dhe buxheteve të komunave, por me ndërhyrje të sigurimeve shëndetësore themelore dhe private. Këto sigurime do të zbatohen nëpërmjet sigurimeve të detyrueshme dhe vullnetare, në agjencion të sigurimeve shëndetësore dhe në fondin e sigurimeve shëndetësore të Kosovës, i cili duhet të fillojë punën në janar 2005.

Veprimtaria shëndetësore definohet si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, e cila duhet të sigurohet në kuadër të sistemit unik, funksionalisht të lidhur shëndetësor në nivel të Kosovës.

Mbështetja juridike konsiston në ushtrimin e obligimeve dhe përgjegjësisë në punë, kualifikimin, regjistrimin dhe licencimin e institucioneve dhe të punëtorëve shëndetësor, të kontrollit dhe të dispozitave ndëshkuese në rast të mospërbushjes dhe shkeljes së detyrave të subjekteve shëndetësore.

Në fund,ministrja Mumxhiu i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

Pas arsytimit të këtij P/ligji nga ministrja Resmije Mumxhiu,**kryetari** e hapi diskutimin për shqyrtimin në parim të këtij p/ligji.

**Nafije Gash**,në emër të Komisionit për Shëndetësi,tha se në parim e mbështesin këtë p/ligj,por vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i paraqesim gjatë shqyrtimit të p/ligjit përmes amendamenteve,si vijon:Te përkufizimet nën a) thuhet se: «qytetari është personi bartës i lejes së qëndrimit të lëshaur nga autoriteti kompetent», e unë konsideroj se qytetari është ë rend të parë banor i përhershëm i Kosovës, e mund të jetë edhe ai që ka leje qëndrimi, nëse i plotëson kushtet për t'u bërë shtetas i Kosovës;

Në faqën 5, pika h) kur thuhet: «anëtari i ngushtë i familjes» numërohen «partneri bashkëshortor, prindërit, fëmijët, fëmiju i partnerit bashkëshortor, vëllau, motra, njerka ose njerku» - duhet të hiqet «partneri bashkëshortor» se duket se është një përkthim i keq, nuk e di se nga cila gjuhë, por duhet të thuhet vetëm «bashkëshorti – bashkëshortja» dhe kjo duhet të bëhet më vonë gjithkund në tekst;Në kapitullin 3, pika 12.2 Barazia dhe pika 12.5 Gjithpërfshirja, të bëhen bashkë, pasi është i njëjti qëllim dhe e njëjta lëmi.

Gjithashtu, edhe pika 12.6 Sistemi i financimit dhe qëndrueshmëria e tij, të bëhet bashkë me pikën 12.7; Pika 12.8 bashkëfinancimi, gjithashtu të bëhen bashkë dhe me nënpika të qartësojnë dhe përkufizojnë lëndën.

**Fetije Këpuska**,në emër të Grupit parlamentar të LDK-së,tha se e mbështesin këtë p/ligj,por do t'i paraqes disa ide, sugjerime dhe vërejtje në formë të përgjithësuar që do të mund të ishin kontribut modest për shtruarjen, evidencimin dhe përkufizimin edhe të disa aspekteve të cilat në këtë Projekt kanë mbetur paksa jashtë vëmendjes së duhur

Në pjesën hyrëse, duhet nënvizuar se ligji rregullon parimet, masat, mënyrën, zbatimin, organizimin e mbrojtjes shëndetësore, bartësit e aktiviteteve.

Institucionet dhe subjektet mbrojtëse shëndetësore - po ashtu duhet saktësuar se çfarë nënkupton mbrojtja shëndetësore, e cila, si e tillë, përmbledhë një kompleks të masave shoqërore dhe individëve të veprimtarive të shërbimeve në ruajtjen, në avancimin e shëndetit, në përkujdesjen shëndetësore dhe rehabilitimin.

Të drejtat dhe detyrat e personave në realizimin e mbrojtjes shëndetësore, kur bëhet fjalë për barazinë, në tërë procesin – fazat, në të gjitha format e mbrojtjes shëndetësore, duhet numëruar të gjitha të drejtat, madje edhe mundësinë e zgjedhjes me të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me shëndetin e tij, deri te refuzimi i shërimit nga personi jokompetent, të drejtën e refuzimit të pacientit të jetë objekt i eksperimentimit shkencor si dhe një gamë të drejtash të tjera. Ndërkaq, te masat mbrojtëse shëndetësore, duhet paraparë edhe preventimin e sëmundjeve, shërimin dhe rehabilitimin.

Në një kapitull të plotë, jo vetëm me dy pasuse, duhet rregulluar praktikën private, ku do të përfshihen dhe caktohen kushtet që duhet përmbushur personeli shëndetësor që nënkupton kualifikimet përkatëse dhe aftësitë profesionale, hapësirën, pajisjen dhe lejen për punë në ordinancën, laboratorin, pastaj shërbimet që mund të ofrojnë si dhe ato që nuk mund t'i zhvillojnë.

**Sadullah Hoxha**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e mbështesin këtë p/ligj, por vërejtjet tona do t'i paraqesim gjatë fazës së shqyrtimit të tij dhe përmes amendamenteve të nevojshme, do të bëhet një ligj funksional për nevojat afatgjate të përshtatura në kushtet tona dhe të harmonizuara me standarde ndërombëtare të kësaj fushe. Në kapitullin 6 – Organizimi dhe zbatimi i kujdesit shëndetësor, neni 28, lidhur me kujdesin parësor shëndetësor, kur radhiten se çfarë shërbimesh ofrohen, duhet të saktësohet me ligj ofrimi i ndihmave për kujdesin e nënave, ngaqë në maternitetet komunale jashtspitalore ekzistojnë 16 të tilla.

Në nenin 31 të këtij p/ligji, kapitulli lidhur me kujdesin tretësor, duhet të saktësohet roli i Institutit të Mjekësisë Ligjore, pasi që funksionimi i tanishim i një instituti paralel në Rahovec nuk i plotëson nevojat e mjekësisë ligjore.

Në po të njëjtin nen, duhet të figurojë edhe Instituti për Mbrojtjen e Nënave dhe Fëmijëve, i domosdoshëm duke patur parasysh mbrojtjen adekuate të kësaj kategorie.

Në kapitullin 12 Dispozitat lidhur me të vdekurin dhe obduksionin, neni 33, duhet më mirë të definohet obduksioni sidomos në nivelin tretësor, pra në Qendrën Klinike Universitare.

Në nenin 84 të duhet të saktësohet dhe të plotësohet obduksioni i domosdoshëm.

Në po të njëjtin kapitull, veprimtaria e pavarur shëndetësore, neni 96 duhet të saktësohet.

Edhe në kapitullin 17, neni 112, lidhur me sterilizimin artificial, saktësohet sterilizimi vetëm për femra. Dihet se mund të sterilizohen edhe meshkujt, duhet të saktësohet me ligj.

**Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se e mbështesin në parim, këtë p/ligj dhe gjatë shqyrtimit të tij, përmes amendamenteve, duhet të plotësohet, në mënyrë që ai më lehtë të zbatohet në praktikë.

P/ligji ka një kornizë të mirëfilltë ligjore, por është shumë i përgjithësuar, edhe vetë hartuesi i tij thotë se për zbatimin e tij në praktikë, Qeveria duhet të nxjerrë 10 rregullore dhe 38 udhëzime administrative.

Ministrisë së Shëndetësisë i jepen shumë kompetencat pa u cekur askund transparenca për punën e saj. Veprimtaria shëndetësore primare përshkruhet hollësisht, ndërsa sipërfaqësisht përmendet veprimtaria shëndetësore sekundare dhe terciare, por prap premtohet se kjo fushë do të rregullohet me udhëzime administrative.

Nuk përmendet askund raporti ndërmjet organizatave joqeveritare, siç është shoqata e mjekëve, që në praktikë e ka rëndësinë e posaçme.

**Svetomir Samarxhiq**, në emër të grupit parlamentar “Kthimi” theksoi se veprimtaria shëndetësore është më komplekse se të tjerat, sepse ajo shfrytëzohet pa reshtur që nga lindja në spital deri në vdekje, kur përfundon jeta përsëri në spital.

Po në ç’moment ne po nxjerrim këtë ligj, çfarë janë rrethanat aktuale në Kosovë kur po nxirret ky ligj?

Koalicioni “Povratak” parimisht është për nxjerrjen e këtij ligji. Mirëpo, praktika bashkëkohore e mjekësisë nënkupton që të analizohen mirë nevojat shëndetësore të popullsisë. Kësaj here analiza dhe hulumtime të tilla nuk janë bërë në Kosovë.

Po të vlerësonin idetë e paraqitura në këtë ligj, lirisht mund të themi se është utopist dhe pastaj do të vazhdohet se për të gjithë banorët mbrojtja shëndetësore do të jetë falas.

Ne si koalicion do të marrim pjesë aktive në punë edhe në formulimin e amendamenteve që do të përmirësonin ligjin e mbrojtjes shëndetësore, por nëse interesat tona nuk janë të mbrojtura, ne do të votojmë kundër këtij ligji.

**Faik Marolli**, në emër të Grupit Parlamentar nga komunitetet e tjera, tha se e mbështesin në parim këtë p/ligj dhe gjatë shqyrtimit të tij, do të angazhohen për plotësimin në ato fusha, që janë në interes të shëndetit për të gjithë qytetarët e Kosovës.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet në këtë p/ligj i dhanë edhe këta deputetë: Nekibe Kelmendi, Hasan Meta, Muhamed Kelmendi, Cveta Vujiçiq, Teuta Hadri, Smajl Latifaj, Rada Trajković, Nurishahe Hulaj, Mehdi Bardhi, Rangjell Nojkiq, Blerim Baruti, Fadil kryesiu dhe Lirak Çelaj që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas diskutimit të deputetëve, kryetari e hodhi në votë këtë p/ligj dhe rezultati është, si vijon:

Për-----shumica;  
Kundër-----2;  
Abstenime-----12.

**Kryetari konstatoi** se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për shëndetësi dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Shëndetësor ta shqyrtonin këtë p/ligj në afat prej tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

### **3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve**

**Kryetari** e hodhi në votë rekomandimin e Komisionit dhe rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----shumica;  
Kundër-----1;  
Abstenime-----13.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi vendimin për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si vijon:

1. Sebahate Hoti, gjyqtare në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë,
2. Fatmir Baloku, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Istog,
3. Daut Demiraj, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Istog,
4. Ramadan Gudaci, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Kaçanik,,
5. Riza Livoreka, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Kaçanik,
6. Asllan Krasniqi, gjyqtar në Gjykatën për Kundërvajtje në Malishevë;
7. Shyqyri Sylja, zv.prokuror në Gjykatën Komunale në Mitrovicë;
8. Nada Topliçeviq- gjyqtare në Gjykatën për Kundërvajtje në Mitrovicë.

Kuvendi nuk e miratoi propozimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës që kandidatja Branka Careviq, të emërohet gjyqtare në Gjykatën për Kundërvajtje në Shtërpcë.

#### **4. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve**

**4.1 Koalicioni «Kthimi»** i kishte parashtruar pyetje kryeministrit lidhur me përdorimin e llogos të IVPK-së.

**Kryeministri** i ishte përgjigjur me shkrim pyetjes së parashtruar të koalicionit «Kthimi».

**4.2 Deputeti Alush Gashi** i kishte parashtrua pyetje kryeministrit lidhur me hartimin e P/ligjit për zgjedhjet.

**Kryeministri** i ishte përgjigjur me shkrim pyetjes së deputetit Alushu Gashi.

**Deputeti Alush Gashi** tha se nuk është i kënaqur me përgjigjen e kryeministrit dhe e fton atë t'i përgjigjet gojarisht, në seancën e ardhshme plenare.

**4.3 Deputeti Ismajl Kurteshi** i kishte parashtruar pyetje ministrit Goran Bogdanoviq lidhur me furnizimin me farna të drithit.

**Ministri Goran Bogdanoviq** i ishte përgjigjur me shkrim pyetjes të deputetit Ismajl Kurteshi.

**Deputeti Ismajl Kurteshi** tha se nuk është i kënaqur me përgjigjen e ministrit Goran Bogdanoviq dhe e fton atq që të përgjigjet gojarisht, në seancën e ardhshme plenare.

**4.4 Deputeti Ismajl Kurteshi** i kishte parashtruar pyetje ministrit Ethem Çeku lidhur me ruajtjen e tokës pjellore, mbrojtjen e lumenjve nga ndotja me ujëra të zeza dhe mbrojtjen e pyetjeve.

**Ministri Etem Çeku** iu përgjigj gojarisht pyetjes të deputetit Ismajl Kurteshi.

#### **5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të datës 20 nëntor 2003**

Kuvendi, me propozimin e Kryesisë, e miratoi rendin e ditës për seancën plenare të datës 20 nëntor 2003, si vijon;

1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për sportin-nr.2003/27;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për kadastër-nr.2003/30 dhe
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për transportin rrugor-nr.2003/32.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 12:30 minuta.

**Sekretaria e Kuvendit**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

---

**Akademik Nexhat DACI**